

1. Pershkrim i pergjithshem

Shoqëria tregtare “Iute Credit Albania” sh.a është themeluar si një shoqëri aksionare më 4 Gusht 2014 dhe vepron në përputhje me ligjin “Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjeve të tjera që rregullojnë biznesin në Shqipëri. Ne regjistrin tregtar (QKR) Shoqëria është e identifikuar me NUIS-in L42011023U dhe selia kryesore e saj ndodhet në adresën: “Rruga Andon Zako Cajupi”, ND 3, Hyrja Nr 2, Njësia administrative nr.5, Tiranë.

Kapitali i regjistruar i saj është 100,000,000 Lek (31 Dhjetor 2021: 65,000,000 Lek) dhe zotërohet nga aksioneri i vetëm shoqëria “AS Iute Credit Europe” me qendër në Estoni, e cila është pala kontrolluese finale.

Shoqëria operon si institucion mikrofinanciar me miratim nga Banka e Shqipërisë me licencë nr. 32, datë 31 Mars 2015.

Struktura e aksionerëve të shoqërisë si më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
	%	%
AS Iute Credit Europe	100%	100%
Total	100%	100%

2. Bazat e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe interpretimeve të lëshuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve të Raportimit Financiar i BSNK.

Keto pasqyra u autorizuan nga Drejtimi i shoqërisë me 25 janar 2023 për aprovim nga Asambleja e Aksionerëve.

3. Permbledhje e politikave të rëndësishme kontabel**3.1 Standardet e reja dhe ato të ndryshuara efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 Janar 2022**

- Koncesionet e Qirave që lidhen me COVID-19 pas 30 qershorit 2021 (Perditesime në SNRF 16) 01 Prill 2021
- Kontratat me kushte të rënduara – Kostoja e përmbushjes së një kontrate – (Perditesime në SNK 37) 01 janar 2022
- Përmirësimet vjetore të Standardeve SNRF 2018–2020 - 01 janar 2022
- Aktivët afatgjatë materiale: Shuma përpara përdorimit të synuar – (Perditesime në SNK 16) 01 janar 2022
- Referenca në Kuadrin Konceptual (Perditesime në SNRF 3) 01 janar 2022

Standardet e reja që mund të adoptohen më herët

- Shitja ose kontributi në asete ndërmjet një investitori dhe shoqërisë së asocuar të tij ose shoqërisë së përbashkët (Perditesime në SNRF 10 dhe SNK 28)

Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara

- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjatë (Perditesime në SNK 1)
- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit dhe perditesimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit
- Paraqitja e shenimeve shpjeguese për politikën kontabel (Perditesime në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës 2 SNRF).
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabel (Perditesime në SNK 8)
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Perditesime në SNK 12)

3. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)**3.2 Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas bazës së kostos historike. Pasqyrat financiare paraqiten në monedhen Lek. Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë.

Drejtimi i përgatiti këto pasqyra financiare sipas parimit të vijimesise. Referojuni shenimit më poshtë për pasiguritë dhe ngjarjet apo kushtet që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e shoqërisë për të vazhduar aktivitetin sipas parimit të vijimesise.

3.3 Monedhat e huaja**a) Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit**

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek Shqipëtar që është monedha funksionale dhe prezantuese e shoqërisë dhe të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek përveç se kur është shprehur ndryshe.

b) Transaksionet në monedhe të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve. Fitimi apo humbja nga kurset e këmbimit, që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla si dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të mbajtura në monedhë të huaj, njihet në fitim ose humbje.

Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit nuk rivekshtohen në fund viti dhe maten me koston e tyre historike (konvertuar në monedhën funksionale me kursin e asaj date) përveç, aktiveve dhe detyrimeve jo-monetare të matura me vlerën e tregut të cilat konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës kur u përcaktua vlera e tyre e tregut.

Kurset kryesore të konvertimit në Lek Shqipëtar për 1 njësi të monedhes së huaj në datën e raportimit janë si më poshtë

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
EURO	114.23	120.76
USD	107.05	106.54

3.4 Parimi i vijimësisë

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022, Shoqëria njohu një fitim neto prej 281,010,848 Lek (31 December 2021: 496,373,378 Lek). Aktivitetet afatshkurtër neto të Shoqërisë në 31 Dhjetor 2022 ishin 1,351,770,627 Lek (31 December 2021: 1,720,544,622 Lek).

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë dhe nuk përfshijnë ndonjë rregullim të vlerës kontabël dhe klasifikimit të aktiveve, pasiveve dhe shpenzimeve të raportuara që përndryshe mund të kërkohen nëse baza e parimit të vijimësisë nuk do të ishte e përshtatshme.

Drejtimi i shoqërisë beson se ka aktive të mjaftueshme dhe se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të biznesit të shoqërisë në kushtet aktuale. Aftësia e shoqërisë për të vazhduar aktivitetin do të varet gjithashtu dhe nga mbështetja e vazhdueshme financiare nga aksionerët e saj.

3. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

3.5. Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin nëse ka. Kostot historike përfshijnë shpenzimet të lidhura drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitetit. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë koston e materialeve dhe të punës së shpenzuar, si dhe çdo kosto tjetër që lidhet me sjelljen e aktivitetit në kushte pune për qëllimin për të cilin janë krijuar, kostot e cmontimit dhe zhvendosjes së aktivitetit dhe kthimit të vendit të punës ku aktiviteti ishte vendosur në gjendjen e tij fillestare dhe kostot e huamarrjes që lidhen me aktivitetin e kualifikuar për t'u kapitalizuar. Kur pjesë të ndryshme të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme të dobishme, ato kontabilizohen si pjesë më vete (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot e mëtejshme

Kostot e mëtejshme përfshihen në vlerën e mbetur kontabël të aktivitetit, apo njihen si aktiv më vete nëse është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhen me aktivitetin në fjalë do të merren nga shoqëria dhe kostoja mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet e përditshme që i shërbejnë aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime të periudhës kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale. Toka nuk zhvlerësohet. Normat vjetore të amortizimit duke u bazuar në jetën e dobishme të vlerësuar janë si me poshtë:

	2022	2021
Pajisje zyre	20%	20%
Pajisje informatike	25%	25%

3.6 Aktive afatgjata jomateriale

(a) Program kompjuterik

Licensat për programet kompjuterike të blera kapitalizohen mbi bazën e shpenzimit të bërë për të blerë dhe vënë në përdorim programin. Markat dhe listat e klientëve të blera gjatë kombinimeve të bizneseve e që kualifikohen për t'u njohur më vete njihen si aktive afatgjata jomateriale me vlerë të drejtë. Normat vjetore të amortizimit duke u bazuar në jetën e dobishme të vlerësuar për programet kompjuterike janë 25%.

3.7 E drejta per te perdorur aktive afatgjata materiale

Qirate e klasifikuara si qira operative bazuar ne SNK 17

Te drejtat per te perdorur aktivet jane njohur me:

- vleren e tyre te mbetur sikur SNRF 16 te ishte aplikuar qe nga data e fillimit, te skontuara me normen e brendshme te borxhit te Shoqerise ne daten e aplikimit per here te pare: Shoqeria aplikoi kete metode per aktivet me vlere me te madhe

Shoqeria perdori disa perjashtime praktike gjate aplikimit te SNRF 16 tek qirate te cilat me pare ishin klasifikuar si qira operative sipas SKN 17. Ne vecanti Shoqeria perdori keto perjashtime si me poshte:

- nuk njohu te drejten per te perdorur aktivin dhe detyrimin per qirane per ato qira te cilat kishin maturitet me te vogel se 12 muaj qe nga data e aplikimit;
- nuk njohu te drejten per te perdorur aktivin dhe detyrimin per qirane per ato qira te cilat kishin vlere te vogel (p.sh. ato aktive me vlere me te vogel se 5 mije Euro ose ekuivalenti i tyre ne Lek).

3. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

3.7 E drejta per te perdorur aktive afatgjata materiale (vazhdim)

SNRF 16 Qirate

Ne matjen e detyrimit te qirase per qirate e klasifikuara si qira operative, shoqeria ka skontuar vleren aktuale te pagesave te qirase duke perdorur normen e huamarrjes. Norma e koston mesatare te ponderuar e aplikuar eshte 10.38%.

Ne fazen fillestare te qirase, shoqeria vlereson nese kontrata eshte ose permban nje qira. Kontrata eshte ose permban nje qira, nese kontrata jep te drejten e kontrollit mbi perdorimin e nje aktivi te identifikueshem per nje periudhe kohe ne kembim te njehshme. Per te vleresuar nese kontrata eshte ose permban te drejten e kontrollit te perdorimit te aktivi te identifikueshem, shoqeria perdor perkufizimin e qirase sipas SNRF 16.

Si nje qiramarres

Ne fazen fillestare ose pergjate ndryshimit te nje kontrate e cila permban nje qira, shoqeria shperndan shumen ne kontrate tek secili perberes qira mbi bazen e cmimit specific perkates te perberesit qira. Gjithsesi, per qirate e ndertesave, shoqeria ka zgjedhur te mos i vecoje perberesit jo-qira nga perberesit qira dhe ta trajtojte secilin perberes qira dhe ndonje perberes jo-qira te lidhur me te si nje perberes te vetem qiraje.

Ne daten e fillimit, shoqeria ka njohur nje aktiv me te drejte perdorimi dhe nje detyrim te qirase. E drejta per te perdorur aktivin eshte njohur me kosto, e cila perfshin shumen e matjes fillestare te detyrimit te qirase, te axhustuar per pagesat e qirase te kryera perpara ose ne daten e fillimit, plus cdo kosto follestare te drejteperdrejte te kryer nga qiramarresi, dhe nje vleresim te kostove qe do te ndodhin nga qiramarresi per cmontim dhe levizjen e aktivit baze, restaurimi i aktivit baze ne kushtet e kerkuara, minus cdo stimul qiraje te marre.

Aktivi me te drejte perdorimi eshte amortizuar bazuar ne metoden lineare prej dates se fillimit te qirase deri ne fund te periudhes se qirase pervec nese qiradhenesi transferon pronesine e aktiviteti baze te shoqeria ne fund te afatit te qirase ose kosto e aktiviteti me te drejte perdorimi reflekton se qiramarresi do te ushtroje nje opsion blerje. Ne kete rast aktiviteti me te drejte perdorimi do te amortizohet nga data e fillimit deri ne fund te jetes se dobishme te aktiviteti baze, e cila percaktohet ne te njejte baze si aktiviteti afatgjata materiale. Pervet kesaj, aktiviteti me te drejte perdorimi do te zvogelohet per zhvleresime nese ka, dhe axhustuar per te reflektuar cdo modifikim te detyrimit te qirase.

Ne daten e fillimit, detyrimi i qirase eshte njohur me vleren aktuale te pagesave te qirase, te cilat nuk jane paguar ende ne ate date, te skontuara duke perdorur normen e interesit te percaktuar te qirase, nese kjo norme nuk mund te percaktohet lehte, perdoret kosto e huamarrjes se shoqerise. Pergjithesisht, shoqeria perdor normen e interesit te huamarrjes si norme skontimi.

Shoqeria ka percaktuar normen rritese te huamarrjes duke marre normat e interesit nga disa burime financimi te jashtme dhe duke e axhustuar per te reflektuar temat dhe kushtet e aktiveve te marra me qira.

Pagesat e qirase perfshin pagesat fikse, duke perfshire pagesat fikse ne thelb te qirase.

Detyrimi i qirase eshte vleresuar me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Qirate afatshkurtra dhe qirate per aktive me vlere te ulet

Shoqeria ka perzgjedhur te mos njoh te drejten e perdorimit te asetit per qirate per te cilat aktiviteti baze eshte me vlere te ulet dhe qirate afatshkurtra. Shoqeria i njeh shpenzimet e lidhura me keto qira si shpenzime ne menyre lineare pergjate kohezgjatjes se qirase.

3. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

3.8 Instrumentat financiare

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentave financiarë dhe matet fillimisht me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit, me përjashtim të atyre të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes të cilat fillimisht janë të matura me vlerë të drejtë dhe kostot e transaksionit janë shpenzuar në fitimin ose humbjen.

i. Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare

SNRF 9 përmban tre kategori kryesore të klasifikimit për aktivet financiare: matur me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse ose me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Klasifikimi i aktiveve financiare sipas SNRF 9 në përgjithësi bazohet në modelin e biznesit në të cilin menaxhohet një aktiv financiar dhe karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar.

SNRF 9 eliminon kategoritë e mëparshme të SNK 39, të mbajtura deri në maturim, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe të mbajtura për shitje.

ii. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

SNRF 9 zëvendëson modelin e 'humbjeve të ndodhura' në SNK 39 me një model të 'humbjes së pritshme të kredisë' (ECL). Modeli i zhvlerësimit zbatohet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar.

3.9 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi është zvogëluar dhe zhvlerësimi mund të shoqërohet me ngjarje që ndodhin pas njohjes së zhvlerësimit (si një përmirësim në indeksin e kredisë), humbja nga zhvlerësimi e njohur më parë ndryshohet duke rregulluar llogarinë rezervë. Shuma e ndryshimit njihet në të ardhura dhe shpenzime.

3.10 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të parë nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit. Nëse ekziston një tregues i tillë, atëherë vlerësohet shuma e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi ose njësia gjeneruese të fluksit të mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese të mjeteve monetare është grupi më i identifikueshëm i aktiveve që gjenerojnë flukse të mjeteve monetare që janë dukshëm të pavarura nga aktivet ose grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose një njësie gjeneruese është vlera më e madhe midis vlerës në dispozicion dhe vlerës së saj të drejtë pas zbritjes së kostove të shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të mjeteve monetare zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi (para tatimit) që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të aktivitetit dhe rreziqet specifike të aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi ndryshohet nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi rikthehet në masën që vlera e mbetur e aktivitetit nuk e tejkalon vlerën e mbetur që do të ishte përcaktuar pas zbritjes së amortizimit nëse nuk do të ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

3. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

3.11 Kapitali i shoqerise

Kapitali i Shoqerise perbehet nga parate e kontribuara nga themeluesit e Shoqerise. Kapitali i Shoqerise mbahet me vleren ekuivalent ne Lek te kontributit te marre ne monedhe te huaj duke perdorur kursin e kembimit te dates se transaksionit. Kapitali i nenshkruar i Shoqerise njihet me vleren nominale te tij.

3.12 Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjete monetare perfshijne mjete monetare ne arke, llogari rrjedhëse në banka dhe mjete të tjera likuide me maturitet jo me shumë se tre muaj te cilat jane subjekt i ndryshimve jo-sinjifikative te ndryshimeve ne vleren e tyre te tregut dhe qe perdoren nga Shoqeria ne manaxhimin e angazhimeve te saj afatshkurtra. Mjetet monetare mbahen ne vleren e tyre te amortizuar ne pasqyren e pozicionit financiar.

3.13 Njohja e te ardhurave

(a) Te ardhura nga interesat

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të pranuar, kostot e transaksionit dhe uljet ose primet që janë një komponent i rëndësishëm i interesit efektiv. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes, emetimit ose shitjes së aktivitetit ose detyrimit financiar. Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e përfshira në fitim ose humbje përfshijnë interesin mbi aktivitetin dhe detyrimet financiare me koston e amortizuar në bazë të interesit efektiv.

(b) Te ardhura nga komisionet

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet janë shkaktuar nga shërbimet financiare të ofruara nga Shoqëria. Të hyrat nga tarifat dhe komisionet njihen në kohën kur ofrohet shërbimi. Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose pasiv financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit. Kur një angazhim kredie nuk pritët të rezultojë në një tërheqje kredie, tarifat e komisionit njihen në mënyrë lineare gjatë periudhës së marrëveshjes.

3.14 Te ardhura te tjera operative

Të ardhura te tjera operative perfshijne komisione dhe tarifa te tjera administrative qe lidhen me penalitetet e aplikuar, te cilat jane njohur pergjate kohes se kryerjes se shërbimit.

3.15 Kostot e huamarrjes

Shpenzimet e huamarrjes qe jane te lidhura direkt me blerjen, ndertimin apo prodhimin e nje aktiviteti kualifikuar, te cilet jane aktive qe kerkojne nje periudhe kohe te konsiderueshme per tu bere gati per qellimin e perdorimit te tyre, i shtohen vleres se ketyre aktiveve, per aq kohe sa nevojitet qe keto aktive te jene gati per perdorimin e parashikuar apo per tu shitur. Te gjitha kostot e tjera te huamarrjes njihen ne te ardhura dhe shpenzime ne periudhen kur ndodhin.

3.16 Perfitimet e punonjesve

Sigurimet shëndetësore dhe shoqërore të detyrueshme

Ne rrjedhen normale te biznesit shoqeria, kryen pagesa me emer te vet dhe ne emer te punonjesve te saj per te kontribuar ne pensionin e detyrueshem sipas legjislacionit lokal. Kostot e pesuara nga ana e shoqerise jane ngarkuar ne pasqyren e te ardhurave ne momentin kur ndodhin.

3.17 Te tjera shpenzime operative

Shpenzimet e tjera operative njihen mbi bazen e kontabilitetit rrites kur ato ndodhin.

3. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

3.18 Tatimi mbi fitimin aktual dhe tatimi mbi fitimin i shtyre

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfshijnë tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Shpenzimet për tatimin mbi fitimin njihet ne te ardhura shpenzime pervec se kur ai i referohet zerave te njohura direkt ne kapital ose ne te ardhurat e tjera gjithperfshirese. Tatimi aktual është tatimi i prituri i pagueshëm mbi fitimin e pagueshëm të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara apo të miratuara në masë substanciale në datën e bilancit, dhe ndonjë rregullim të tatimit fitimit të pagueshëm lidhur me vitin e mëparshëm. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin është 15% mbi fitimin e tatueshem.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke krijuar provigjon për diferencat e përkohshme midis bazës tatimore dhe vlerave të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi apo që do të hyjë më vonë në fuqi përgjatë periudhës së rimarrjes.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të vlefshme kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivët tatimore të shtyra reduktohen në masën që përfitimet tatimore në lidhje me to janë të mundshme të realizohen.

3.19 Provigjonet

Provigjonet njihen atëhere kur: Shoqëria ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara; ka më shumë mundësi se sa jo që një reduktim burimesh do të jetë i nevojshëm për të shlyer detyrimin; dhe shuma mund të vlerësohet me besueshmëri.

Nese efekti i tyre është i konsiderueshem, provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë para taksave që reflekton vlerësimin aktual të vlerës në kohë të parase dhe ku është e nevojshme, risqet specifike të lidhura me detyrimin. Provigjonet rishikohen çdo data raportimi dhe nese nuk ka më mundësi që një reduktim burimesh të kërkohej për të shlyer detyrimin, provigjonet duhet të anulohen. Provigjonet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin u krijuar fillimisht. Provigjonet nuk njihen për të mbuluar humbjet e ardhshme operative aktivet dhe detyrimet e mundshme nuk njihen.

3.20 Transaksionet me palet e lidhura

Transaksionet me palet e lidhura përfshijnë aksionerët dhe drejtoret e shoqërisë, së bashku me entitete që ato kontrollojnë të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e Shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme të tretë vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

3.21 Angazhimet dhe detyrime të kushtezuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shenimet shpjeguese përveç rasteve kur mundësia e konsumimit të burimeve që kanë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivët e kushtezuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shenimet sqaruese kur një hyrje e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes së kushtezuar njihet si provigjon nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigjonin, një detyrim njihet në ditën e pasqyrës së pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme

3. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

3.22 Ngjarjet pas dates se raportimit

Ngjarjet pas dates se raportimit te cilat vene ne dispozicion informacion shtese mbi pozicionin e shoqerise ne daten e pasqyrave te pozicionit financiar (ngjarje rregulluese), reflektohen ne pasqyrat financiare. Ngjarjet pas dates se bilancit te cilat nuk jane ngjarje rregulluese, paraqiten ne shenimet shpjeguese kur jane materiale.

4. Gjykimet kontabel dhe burimet kryesore te pasigurise se vleresimit

Ne aplikimin e politikave kontabel te shoqerise te cilat paraqiten ne shenimin 3, drejtimit i kerkohet qe te beje gjykime, vleresime dhe supozime per vleren e mbartur te aktiveve dhe detyrimeve qe nuk jane qartesisht te dukshme nga burime te tjera. Vleresimet dhe supozimet e lidhura me to jane te bazuara ne eksperiencen historike dhe faktore te tjere qe konsiderohen te rendesishem. Rezultatet aktuale mund te ndyshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet rishikohen rregullisht. Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi rishikohet, nese rishikimi ndikon vetem ne ate periudhe ose ne periudhen e rishikimit dhe ne periudhat e ardhshme nese rishikimi ndikon si ne periudhen aktuale dhe te ardhshme.

Pasiguri ne gjykim

Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Nje humbje nga zhvleresimi njihen ne masen qe vlera kontabel e aktivitetit te tejkaloj shumen e tij te rikuperueshme. Kur percaktohet vlere e rikuperueshme, drejtimi vlereson cmimet e pritshme dhe flukset e monetare nga cdo njesi gjeneruese te mjeteve monetare dhe percakton nje norme te pershtatshme te interesit kur llogaritet vleren aktuale te ketyre flukseve.

Jeta e dobishme e aktiveve te amortizueshme

Drejtimi rishikon jeten e dobishme te aktiveve te amortizueshme ne cdo date te pasqyres te pozicionit financiar. Drejtimi gjykon qe jeta e percaktuar e dobishme te aktiveve perfaqson dobine e pritshme te aktiveve. Vlerat e mbartura te ketyre aktiveve jane analizuar ne shenimet 7 dhe 8. Megjithate, rezultatet faktike mund te ndryshojne per shkak te daljeve jashte perdorimit nga ndryshimet teknologjike.

Zhvleresimi i aktiveve financiare

Shoqëria rregullisht teston per zhvlerësim te arkëtueshmet e saj. Gjatë kryerjes se ketyre testeve shoqëria mer parasysh pagesat e rregullta të bera, pra debitori, pozicionin e tij financiar dhe operacionet, arketueshmerine e pagesave nga instrumentat financiare dhe një numer kriteresh te tjera te perdorura per te vleresuar arketueshmerine.

Zhvleresimi i aktiveve financiare: ne percaktimin e inputeve te modelit ECL (humbjes se pritshme te kredise), perfshihen dhe inkorporohen informacione te ardhshme.

5. Menaxhimi i riskut financiar

Faktoret e riskut financiar

Politikat dhe procedurat e Shoqërisë sigurojnë direktiva për monitorimin dhe menaxhimin e risqeve financiare gjatë ushtrimit të aktivitetit. Këto risqe përfshijnë riskun e kredise, riskun e tregut (që përfshin rikun e kursit të këmbimit dhe riskun e normave të interesit) dhe riskun e likuiditetit.

Menaxhimi i riskut bëhet nga drejtimi i Shoqërisë bazuar në disa politika dhe procedura të shkruara e të para aprovuara që mbulojnë menaxhimin e përgjithshme të riskut sikurse dhe pjesë specifike siç është risku i kursit të këmbimit, risku i normave të interesit, risku kredise, përdorimin e masave të duhura për të investuar likuiditetin e tepert.

Risku i tregut

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut nëpërmjet përdorimit të instrumentave të saj financiare dhe specifikisht ndaj riskut të normave të interesit që lindin si nga aktivitetet e saj operative ashtu dhe nga aktivitetet investuese.

Risku i kursit të këmbimit

Shoqëria nuk kryen veprime në monedhe të huaja dhe për rrjedhojë nuk është e ekspozuar nga luhajtjeve të kurseve të këmbimit.

Risku i normave të interesit të vlerës së drejte dhe fluksit të parësë

Të ardhurat e shoqërisë dhe flukset operative të parësë janë kryesisht të varura nga ndryshimet në normat e interesit në treg. Risku nga normat e interesit të shoqërisë kryesisht vjen nga qiradhënia, si dhe nga aktivet dhe nga huatë që kanë interesa. Qiradhëniet me norma interesi të ndryshueshme dhe huatë me norma interesi fikse ekspozojnë shoqërinë ndaj riskut të normave të interesit të flukseve të parase.

Në mënyrë që të përballohet ekspozimi ndaj këtij risku, Shoqëria kontraktonte marrëveshje qiradhënie me klientët me kushte të përafërta me kushtet me të cilat sigurohen fondet. Qiratë financiare riveqen vazhdimisht për të reflektuar zhvillimet e tregut.

5. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)*(a) Risku i kursit te kembimit*

Risku i kursit te këmbimit eshte rreziku qe vjen si pasoje e luhajtes se kursit te kembimit. Ekspozimi total ndaj riskut te kursit te kembimit për shoqërinë në 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 eshte si më poshtë:

31 Dhjetor 2022	EURO	USD	Lek	Totali
Aktivët financiarë				
Hua dhe paradhënie për klientët	-	-	5,941,629,872	5,941,629,872
Mjete monetare dhe ekuivalentët të tyre	143,898,678	-	489,257,631	633,156,309
Te arketueshme nga institucionet financiare	-	-	41,182,038	41,182,038
Të tjera të arkëtueshme	411,227	-	83,658,838	84,070,065
	144,309,905	-	6,555,728,379	6,700,038,284
Detyrimet financiare				
Huamarrje	-	-	4,759,578,874	4,759,578,874
Obligacion korporate	-	-	-	-
Detyrime per qirane	112,234,472	-	8,896,658	121,131,130
Llogari të pagueshme dhe të tjera	148,802,711	-	232,594,907	381,397,618
Detyrime te tjera	-	-	83,135,071	83,135,071
	261,037,183	-	5,084,205,510	5,345,242,693
Pozicioni neto	(116,727,278)	-	1,471,522,869	1,354,795,591
31 Dhjetor 2021	EURO	USD	Lek	Total
Aktivët financiarë				
Hua dhe paradhënie për klientët	-	-	4,599,964,666	4,599,964,666
Mjete monetare dhe ekuivalentët të tyre	318,690,713	-	199,368,036	518,058,749
Te arketueshme nga institucionet financiare	-	-	21,052,263	21,052,263
Të tjera të arkëtueshme	5,458	-	44,596,755	44,602,213
	318,696,171	-	4,864,981,720	5,183,677,891
Detyrime financiare				
Huamarrje	-	-	3,473,671,182	3,473,671,182
Detyrime per qirane	62,561,439	-	8,536,240	71,097,679
Llogari të pagueshme dhe të tjera	190,936,440	-	80,447,571	271,384,011
Detyrime te tjera	-	-	64,054,482	64,054,482
